




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

ZHVILLIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR PËR QENDRAT
HISTORIKE BERAT DHE GJIROKASTËR



RAPORT

MBI REZULTATET E KONSULTIMIT ME KOMUNITETIN



Tiranë, 2022



GRUPI I PUNËS

Nën Kujdesin e

*Rudina Zoto
Elena Mamani
Lorenc Bejko*

*Drejtore i përgjithshëm IKTK
Drejtore Ekzekutive CHwB Albania
Përgjegjëse Departamenti, FHF*

Koordinimi i punës për realizimin e konsultimit dhe metodologjisë

*Marsela Plyku Demaj
Mirian Bllaci*

*IKTK
CHwB Albania*

Koordinator i Studentëve

Erinda Ndreçka

FHF

Kontribuan në hartimin e pyetësorit

*Marsela Plyku Demaj
Joli Mitrojorgji
Klodjana Gjata
Fiona Sarapuli
Evadiola Tare*

*IKTK
IKTK
IKTK
IKTK
IKTK*

Dizenjimi në google forms dhe administrimi i të dhënave

Fiona Sarapuli

IKTK

Hartimi i udhëzuesit për studentët

*Fiona Sarapuli
Evadiola Tare*

*IKTK
IKTK*

Koordinim i procesit në terren

*Eugen Kallfani
Luçiana Zanati
Pezana Rexha
Blerina Nora
Anisa Mano*

*Drejtore DRTK Berat
DRTK Berat
Drejtore, DRTK Gjirokastrë
DRTK Gjirokastrë
CHwB Albania*

Studentët që u angazhuan në punën në terren

*-
autorë të fotografive gjatë punës*

*Anabela Sheme,
Blerona Hoxha,
Eleni Doko,
Paula Nazëraj,
Entela Allgjata,
Eugerta Bukali*

*Emina Uka,
Eriselda Sakaj,
Xhoana Malaj
Kristina Kumati*

Hartimi i raportit

*Marsela Plyku Demaj
Fiona Sarapuli*

*IKTK
IKTK*

PËRMBAJTJA

1.	FALENDERIME	4
2.	MBI ZHVILLIMIN E PROJEKTIT	4
3.	OBJEKTIVAT	4
4.	METODOLOGJIA	5
1.	Bashkëpunimi ndërinstitutional	5
2.	Zhvillim i takimeve prezantuese me institucionet dhe studentët e angazhuar në projekt	5
3.	Hartimi i një pyetësoi të dedikuar për komunitetin	5
4.	Hartim i një udhëzuesi për anketuesit	6
5.	Realizimi i pyetësoi në terren	6
6.	Administrimi i të dhënave të pyetësoi	8
5.	REZULTATET	8

1. FALENDERIME

Për realizimin e procesit të konsultimit me komunitetin Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) falënderon CHwB Albania, për mundësimin e mbështetjes financiare për realizimin e pranisë së studentëve në punën në terren, si dhe për bashkëpunimin pozitiv në realizimin e kësaj nisme të përbashkët. Gjithashtu falënderojmë Departamentin e Arkeologjisë dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore, Fakulteti i Histori – Filologjisë (FHF), Universiteti i Tiranës (UT) për pranimin e ftesës për përfshirjen e studentëve në këtë proces. Falënderojmë Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Berat dhe Gjirokastrë për bashkëpunimin në ndjekjen e punës në terren dhe në orientimin e studentëve për të prekur sa më shumë zona gjatë procesit.

Një falenderim i veçantë për angazhimin serioz, qasjen positive dhe kujdesin me regjistrimin e të dhënave, i takon dhjetë studenteve që punuan terren të ndara në dy grupe përkatësisht në Gjirokastrë: Anabela Sheme, Blerona Hoxha, Eleni Doko, Paula Nazëraj, Entela Allgjata, Eugerta Bukali dhe në Berat: Emina Uka, Eriselda Sakaj, Xhoana Malaj dhe Kristina Kumati.

2. MBI ZHVILLIMIN E PROJEKTIT

Projekti për “Zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë” është ndërmarrë nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në kuadrin e vendimeve të vazhdueshme të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, në lidhje me nevojën urgjente të hartimit të një Plani Menaxhimi të Integruar (PMI), për Pronën Pasuri Botërore “Qendrat Historike të Gjirokastrës dhe Beratit”. Projekti udhëhiqet nga IKTK-ja nën koordinimin e Qendrës së Trashëgimisë Botërore (QTB) të UNESCO-s, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Trashëgimisë Botërore, si dhe në bazë të Legjislacionit Shqiptar për Trashëgiminë Kulturore. Projekti realizohet nën koordinimin dhe bashkëfinancimin e UNESCO-s dhe shtetit Shqiptar, nëpërmjet programit për asistencë ndërkombëtare – kërkesë e miratuar në vitin 2019 me kontratë të firmosur nga IKTK dhe QTB në vitin 2021. Projekti zhvillohet në periudhën Janar – Dhjetor 2022, me asistencën teknike të dy ekspertëve ndërkombëtar nga ICOMOS dhe ICCROM, të përzgjedhur dhe kontraktuar nga QTB.

3. OBJEKTIVAT

Objektivat kryesore të projektit paraqiten si më poshtë:

1. Zhvillimi i PMI-je bazuar në një analizë të detajuar të gjendjes ekzistuese dhe të vlerave të trashëgimisë kulturore.
2. Përdorimi i qasjes së Rekomandimit mbi Peizazhin Historik Urban (2011).
3. Përfshirja e komponentit për menaxhimin e riskut për zbutjen e kërcënimeve të fatkeqësive natyrore dhe / ose të shkaktuara nga njeriu.
4. Harmonizimi i dokumentave për administrimin e zonës në aspektin e konservimit, zhvillimit ekonomik e atij të territorit.
5. Sigurimi i bashkëpunimit ndër-institucional nëpërmjet konsultimit të të gjithë palëve të interesit duke përfshirë dhe shoqërinë civile.

4. METODOLOGJIA

Përfshirja e shoqërisë civile si dhe e komunitetit lokal në projektet e trashëgimisë kulturore nëpërmjet fushatave informuese, dëgjësive si dhe takimeve konsultative është gjithmonë e më shumë në fokus të institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Me qëllim realizimin e një procesi konsultimi gjatë hartimit të PMI-së, është ndjekur metodologjia si më poshtë:

4.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ndërmori iniciativën për të realizuar një bashkëpunim ndërinstitucional me CHwB Albania (pjesë e palëve të interes në projekt) me qëllimin e përbashkët të aplikimit të të gjitha formave, të cilat mundësojnë një përfshirje sa më aktive të komunitetit në këtë projekt. I gjithë procesi i konsultimit me komunitetin u realizua në koordinim të ngushtë mes IKTK-së, CHwB Albania dhe Departamentit të Arkeologjisë dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe me bashkëpunimin e DRTK-ve Berat dhe Gjirokastrë. Pyetësi dhe metodologjia u koordinuan nga IKTK. Mundësimi i angazhimit të studentëve në proces për realizimin e punës në terren, u realizuar falë mbështetjes financiare nga CHwB. Mbikëqyrja e procesit në terren u realizua nga DRTK-të Berat dhe Gjirokastrë si dhe zyra e CHwB-së në Gjirokastrë.

4.2 Zhvillim i takimeve prezantuese me institucionet dhe studentët e angazhuar në projekt

Arritja e bashkëpunimit me institucionet palë, bëri të mundur nisjen e procesit të prezantimit dhe njohjes të të gjitha palëve me objektivat e projektit, si edhe me metodologjinë dhe objektivat e konsultimit me komunitetin e Qendrave Historike në Berat dhe Gjirokastrë. Një takim orientues me këtë qëllim, u zhvillua në datën 18 maj në ambjentet e FHF-së.



Fig.1 Foto nga takimi orientues i zhvilluar nga IKTK dhe CHwB në ambjentet e FHF-së

4.3 Hartimi i një pyetësi të dedikuar për komunitetin

Me qëllim grumbullimin e të dhënave në mënyrë të unifikuar, u hartua nga grupi teknik i IKTK-së, një pyetësor kushtuar komunitetit vendas (banorë, përdorues, vizitorë etj.). Ideimi i pyetësit ishte një tjetër proces me rëndësi, i cili kishte për qëllim njohjen me këndvështrimin e banorëve vendas mbi vlerat dhe përdorimin e pasurisë botërore. Ai synon të eksplorojë marrëdhëniet e tyre me qendrën historike si dhe kontekstin më të gjerë social-kulturor. Me qëllim lehtësimin e procesit të grumbullimit dhe administrimit të të dhënave, pyetësi u dizajnuar në formatin digjital google forms.

4.4 Hartim i një udhëzuesi për anketuesit




Me qëllim kordinimin sa më efektiv të punës së studentëve në zonat historike, njohjen e tyre me pyetjet e pyetësorit, rezultatet e pritshme si edhe identifikimin sa më cilësor të komunitetit, nga grupi teknik i IKTK u hartua një udhëzues i dedikuar. Udhëzuesi përmbante të gjitha informacionet e nevojshme për realizimin e punës në terren.

4.5 Realizimi i pyetësorit në terren

Pyetësori u realizua në datat 23-27 maj 2022 në të dy qendrat historike dhe zonat e mbrojtura të tyre. Gjithsej dhjetë studentë të ndarë përkatësisht, katër në Berat dhe gjashtë në Gjirokastrë, u angazhuan në terren për plotësimin e pyetësorit. Puna e studentëve në terren u ndoq nga specialistë të Drejtorive Rajonale Berat dhe Gjirokastrë si dhe në Gjirokastrë nga përfaqësues të CHwB-së. Pyetësorët u plotësuan fizikisht nga dhjetë anketuesit nëpërmjet intervistave në terren, si dhe të dhënat e secilit pyetësor u ngarkuan në formatin digjital të pyetësorit në google forms. Kopjet fizike të pyetësorëve do të ruhen pranë IKTK-së përgjatë kohëzgjatjes së projektit.

Më poshtë paraqiten foto nga procesi i realizuar në terren në Berat dhe Gjirokastrë.





4.6 Administrimi i të dhënave të pyetësorit

Të dhënat e pyetësorit u administruan nga grupi teknik i IKTK-së nëpërmjet platformës google forms. Të dhënat paraqiten nga ana vizuale me anë të grafikëve si dhe në formë tabelare. Raporti me rezultatet e pyetësorit do të shpërndahet pranë të gjitha palëve të përfshira në projekt si dhe do të jenë pjesë e dokumentit të PMI-së.

5. REZULTATET

Të dhënat e pyetësorëve janë dorëzuar në mënyrë anonime. Pyetësori është plotësuar nga 676 persona, 64 % e të cilëve në Gjirokastrë dhe 36 % në Berat.

Profili i të anketuarve është në përputhje me qëllimin e procesit të konsultimit për njohjen me këndvështrimin e banorëve sa i përket vlerave dhe menaxhimit të qendrave historike, si dhe me njohjen me shqetësimet dhe prioritetet e tyre.

Nga ana e organizatorëve si dhe grupit të anketuesve u pat në vëmendje të ruhej barazia gjinore në përzgjedhjen e personave të anketuar me rezultat përfshirje 45 % meshkuj dhe 55% femra. Sa i përket grupmoshës, shumica e të anketuarve (50 %) janë të grupmoshës mbi 50 vjeç (shiko fig.2).





Fig.2 Profili i të anketuarve në përfundim të procesit të konsultimit

Në përfundim të anketimit, kontributi i komunitetit është si më poshtë, duke u bazuar mbi përgjigjet e dhëna në 15 pyetjet e shtruara ndaj komunitetit:

5.1 Nga të anketuarit, 443 (65%) prej tyre ishin banorë të qendrës historike, dhe 175 (25%) ishin banorë të qytetit apo rrethinave.



5.2 Pjesa më e madhe e të anketuarve njihnin /përdornin apo kishin vizituar elementët e qendrave historike që përbëjnë atributet e Vlerës së Veçantë Universale ku si element më të njohur paraqiten Kalatë (98%) dhe lagjet historike (90 %). Figura e mëposhtme paraqet përgjigjet për secilin element.



- 5.3 Lidhja e ngushtë me historinë dhe monumentet (68%) si dhe aktivitetet në natyrë (70 %) ishin përcaktimet më të shumta të tipareve lidhur me dy qytetet e Beratit dhe të Gjirokastrës. Artizanati, Folklori, Kulinaria si dhe Zhvillimi i panaireve ishin grupi i dytë më i përmendur nga të anketuarit. Ndër aktivitetet më pak të përmendura mund të listohen kujdesi për shëndetin dhe mirëqenien, muzika, artet vizuale, si dhe vlerat shpirtërore / fetare.




- 5.4 Shumica e të anketuarve pohuan se ju pëlqen përdishmëria në qendrën historike (71 %), ju pëlqen peisazhi natyror përreth (90.4 %), janë krenarë që jetojnë në qendrën historike (87.3 %) si dhe mendojnë se zhvillimi i turizmit sjell përfitime për komunitetin (74.2%).




Më pëlqen peizazhi natyror përreth

674 responses




Unë jam krenar që jetoj / ose jam krenar që së shpejti do të jetoj në Qytetin pjesë e Trashëgimisë Botërore

648 responses




Turizmi në Berat / Gjirokastrë sjell përfitime për komunitetin lokal


674 responses



Turizmi në Berat / Gjirokastrë ka disavantazhe për komunitetin lokal

676 responses






5.5 Shumica e të anketuarve shprehen të kënaqur me marrëdhëniet sociale (66 %) dhe kushtet e banimit (62%) në qytetin ku jetojnë.

47 % shprehen të kënaqur me sigurinë, por ndërkohë vetëm 38 % shprehen të kënaqur me cilësinë e mjedisit, 34 % shprehen të kënaqur me kujdesin shëndetësor dhe 32 % shprehen të kënaqur me arsimin.


“Puna dhe të ardhurat” (19 %), “Angazhimi qytetar” (4 %) dhe “Nxitja për krijimin e bizneseve të reja” (14%) janë tre pikat për të cilat shumë pak të anketuar janë shprehur të kënaqur (grafiku në fig. më poshtë).

Këto rezultate sidomos lidhur me pikat për të cilat shumica e të anketuarve ka shprehur nevojën për fuqizim të politikave për punësim, angazhim qytetar dhe nxitje e bizneseve të reja, duhet të jenë orientuese në hartimin e prioriteteve apo objektivave të planit të veprimit në procesin e hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar të të dy qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë.



5.6 Ndër elementët më të përmendura si prioritet gjatë 3-5 viteve të ardhshme në kuadër të zhvillimit të qendrueshëm janë “ndërgjegjësimi për trashëgiminë kulturore”(82%), ndërgjegjësimi ndaj mjedisit (64%), përmirësimi i infrastrukturës publike (57%), ulja e

fenomenit të emigrimit nga qyteti (55 %), dhe rritja e punësimit (45 %), grafiku i detajuar në fig. më poshtë.



5.7 Shumica e të anketuarve shprehen të ndërgjegjësuar për ruajtjen e elementëve të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale si arkitektura e traditës, infrastruktura rrugore tradicionale (me kalldrëm), artizanati dhe mjeshtëritë, kulinaria, dhe tradita e oborreve të lulëzuara.



5.8 Në pyetjen e pyetësorit që synojnë të marrin mendimin e banorëve mbi aspektet që duhen përmirësuar në qendrat historike duke patur parasysh rritjen e mundshme të numrit të vizitorëve në to spikat përmendja e nevojës për përmirësim të transportit publik (70 %) si dhe nevoja për prezantim / interpretim të pasurive kulturore (57 %). Gjithashtu rritja e

numrit të restoranteve (46 %) apo bujtinave (47%) si dhe shërbimet e tjera (41 %) ishin ndër pikat e përmendura. Prishja / rehabilitimi i ndërtimeve informale mbështetet nga vetëm 13.7 % e të anketuarve, shifër që tregon se ende banorët nuk janë të ndërgjegjësuar mbi nevojën e trajtimit apo rehabilitimit të ndërtimeve informale për ruajtjen e vlerave të ansamblit apo përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës.




5.9 Nga anketimi rezulton se angazhimi qytetar në grupime apo organizata me aktivitet në fushat e trashëgimisë është në nivele relativisht modeste (vetëm 38 % e të anketuarve kishin marrë pjesë në organizata me aktivitet në një nga fushat e mëposhtme). Fushat që spikasin më shumë në aktivitetin e organizatave janë fushat e sportit, nismat për mjedisin, nismat për trashëgiminë kulturore, nismat për të drejtat e njeriut dhe nismat për mbarëvajtjen e zonës së banimit.



5.10 Gjithsesi 82.4 % e qytetarëve shprehen të gatshëm për të qenë pjesë e organizimeve vullnetare në rast se menaxhimi i qendrës historike do të paraqiste mundësi për përfshirjen e tyre në përmirësimin e saj (*shiko grafikun më poshtë*).

Nëse menaxhimi i Qendrës Historike do të përfshinte mundësi që qytetarët të jenë aktivë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj, a do t'a konsideronit veten pjesë të vullnetarizmit?

675 responses



5.11 Shqetësimet / Nevojat

Në përfundim të pyetësorit, në këtë pyetje të ngritur ndaj komunitetit, qëllimi ishte fokusimi mbi qasjet dhe shqetësimet e ngritura nga komuniteti lidhur me avantazhet apo disavantazhet e të jetuarit si në Berat dhe në Gjirokastrë. Më poshtë rezultatet e përgjigjeve të të anketuarve:

Grupmosha

- 16-25 vjeç janë 20.2% të anketuar
- 26-35 vjeç janë 10.1% e të anketuarve
- 36-50 vjeç janë 19.6% e të anketuarve
- mbi 50 vjeç janë 50.1% e të anketuarve

Numri i përgjigjeve

- 560 përgjigje
- 676 të anketuar

Disavantazhet

- Përmirësimi i infrastrukturës
- Përmirësimi i transportit publik
- Mungesa e Punësimit / Problemi i emigrimit
- Mirëmbajtja e objekteve/banesave në Qendrat Historike
- Mirëmbajtja e mjedisit
- Më shumë aktivitete kulturore
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore
- Zhvillimi ekonomik